

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7854  
E mërkurë, 7 gusht 2024  
Çmimi 0.50

Hoti: Mazhoranca  
mashtrohet lidhur me  
funksionimin e kësaj  
legjislature të Kuvendit  
të Kosovës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI ME TRE MINISTRA TË HËNËN KA VIZITUAR  
MAQEDONINË E VERIUT

## KURTI NË SHKUP: DUAM TË KEMI MARRËDHËNIE TË MIRA FQINJËSORE ME MAQEDONINË E VERIUT | FAQE 3



Kryeministri Albin Kurti, pas takimit me homologun maqedonas Hristijan Mickoski, ka thënë se Kosova dëshiron të ketë marrëdhënie të mira fqinjësore me Maqedoninë e Veriut. Ai ka thënë se janë mirënjohës për kontributin e

kontingjentit ushtarak paqeruajtës të trupave të Maqedonisë së Veriut në kuadër të KFOR-it duke përkrahur përpjekjet për një mjedis të sigurt, paqësor dhe stabil për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kryeministri

Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, ka thënë se si qeveri e re kanë synim të ndërtojnë marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët. Të dy kryeministrat theksuan nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve

### AKTUALE



KOREJA E VERIUT DISLOKON  
250 RAKETAHEDHËS NË KUFİ F. 2

LV-ja: KJO LEGJISLATURË KA  
THYER REKORD TË MIRATIMIT TË  
LIGJEVE F. 3

NEZIRI: INCIDENTI NË AEROPORT  
NUK DO T'I RRËNOJË RAPORTET NË  
MES TË PRISHTINËS DHE SHKUPIT F. 5

### EKONOMI



RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM I  
PRODHIMEVE BUJQËSORE NË  
TREMJORIN E PARË F. 8

HAPET THIRRJA PËR PROGRAMIN  
"PRAKTIKË NË QEVERI" F. 8

### SPORT



NDËRROI JETË IZET GJINOVCİ,  
SIMBOLI I HENDBOLLIT TË  
KOSOVËS F. 10

ABDIXHIKU  
VIZITON  
MINATORËT E  
MBETUR PA PAGA:  
I MBËSHTESIM  
PLOTËSISHT  
KËRKESAT E TYRE F. 7



AKSION  
POLICOR NË  
OBJKTET E  
POSTËS SË  
SERBISË NË  
VERI TË  
KOSOVËS F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Koreja e Veriut dislokon 250 raketahedhës në kufi

**PHENIAN, 5 GUSHT** - Koreja e Veriut ka dislokuar 250 raketahedhës balistikë në kufijtë jugorë, teksa lideri Kim Jong Un i ka përshkruar këto armë si "shpatë e fuqishme dhe e çmuar" për ta mbrojtur sovranitetin e shtetit të tij.

Raketahedhësit u shfaqën gjatë një ceremonie "transferimi" në kryeqytetin e Koresë së Veriut, Phenian, të dielën, raportoi më 5 gusht media shtetërore verikoreane.

Raketahedhësit janë "armë të përditësuara për sulme taktike", citohet të ketë thënë Kim.

Kjo është hera e parë që Koreja e Veriut bëri publike numrin e armëve të transferuara në kufi, tha për AFP-në, Han Kwon-hee, nga Shoqata koreane e Studimeve

të Industrisë së Mbrojtjes.

Këto lloje raketahedhësish janë të dizajnuara të mbajnë katër raketa, tha Han, duke shtuar se furnizimi me armë i Phenianit për Moskën "mund të ketë ndërhyrë në aftësitë e Veriut që të arrijë të prodhojë 1 000 raketa".

Raportet mes dy Koreve janë në pikën më të ulët në vitet e fundit, përderisa Veriu ka shtuar testimin e armëve dhe lëshimin e balona të mbushura me mbeturina drejt Jugut.

Koreja e Jugut është kundërpërgjigjur duke transmetuar propagandë afër kufirit dhe duke rinisur stërvitje ushtarake afër kufirit.

Gjatë këtij viti Pheniani e ka shpallur Seulën "armikun kryesor",



duke hequr dorë nga ribashkimi dhe duke kërcënuar me luftë në rast të shkeljes territoriale.

Kim e pranoi se armët e reja po prezantohen kur shteti po përballet me dëme nga vërshimet.

Ai tha se ky është "manifestim i vullnetit të fuqishëm të partisë sonë për të vazhduar forcimin e kapaciteteve mbrojtëse".

Shirat goditën Korenë e Veriut në fund të korrikut dhe mediet në

Korenë e Jugut thanë se deri në 1 500 persona mund të kenë vdekur si pasojë e shirave.

Kim ha hedhur poshtë këto raportime, duke thënë se synojnë ta prishin imazhin e Veriut, përderisa shteti ka thënë se nuk ka asnjë viktimë si pasojë e shirave.

Gjatë fjalimit, Kimi tha se shteti "po përballet me ndryshime të rëndësishme dhe strategjike për shkak të transformimit të aleancës të udhëhequr nga Uashingtoni në një bllok ushtarak me bazë bërthamore", duke shtuar se një gjë e tillë kërkon që shteti i tij t'i forcojë aftësitë parandaluese. "Forca e ushtrisë sonë duhet të vazhdojë të përmirësohet", tha Kimi.

## Me kërkesë të BE-së, TikTok-u tërheq programin për shpërblimin e përdoruesve

**BRUKSEL, 5 GUSHT** - Rrjeti social TikTok do ta heqë përgjithmonë funksionin e shpërblimeve të përdoruesve në aplikacionin e përdorur në Francë dhe Spanjë, pas presionit nga rregullatorët evropianë, thanë të hënën Bashkimi Evropian (BE) dhe kompania kineze.

Platforma TikTok Lite mbërriti në Francë dhe Spanjë - të vetmet vende të BE-së ku është e disponueshme në prill të këtij viti. Përdoruesit mbi 18 vjeç mund të fitojnë pikë për shikimin dhe pëlqimin e videove, të cilat i shkëmbejnë me mallra si kuponë ose karta dhuratash (gift card) përmes një programi shpërblimi. "Ne ia dolëm ta tërhiqim përgjithmonë programin TikTok Lite Rewards, i cili mund të kishte efekte të varësisë", tha komisionari evropian për Tregun e Brendshëm, Thierry Breton.

TikTok Lite është një version më i vogël i aplikacionit popullor TikTok, i cili merr më pak memorie në telefonin tuaj të mençur dhe është krijuar për të punuar me një lidhje më të ngadaltë interneti.

TikTok u zotua ta heqë programin nga blloku 27-vendesh dhe të mos



ekzekutojë "asnjë program tjetër që do ta anashkalonte tërheqjen", tha Komisioni Evropian në një deklaratë.

Është fitorja e parë e madhe për Aktin e Bashkimit Evropian për Shërbimet Digjitale (DSA), një ligj i ri gjithëpërfshirës që kërkon që firmat digjitale që operojnë në bllok të monitorojnë në mënyrë efektive përmbajtjen në internet për të mbrojtur përdoruesit nga efektet e dëmshme.

Komisioni nisi një hetim mbi aplikacionin Lite në prill për shqetësimet rreth efekteve "varësi"

duke e detyruar TikTok-un të pezullojë përkohësisht programin. Çështja tani është mbyllur pasi TikTok, në pronësi të kompanisë kineze ByteDance, hyri në angazhime të detyrueshme.

Çdo shkelje e premtimit mund të çojë në dënime të rënda, sipas DSA-së. "Ne do të monitorojmë nga afër pajtueshmërinë e TikTok-ut. Vendimi i sotëm dërgon gjithashtu një mesazh të qartë për të gjithë industrinë e mediave sociale", tha zëvendëspresidentja Ekzekutive e Komisionit, Margrethe Vestager. TikTok ka konfirmuar se ka

"tërhequr" programin e shpërblimeve. "Ne gjithmonë përpiqemi të bashkëpunojmë në mënyrë konstruktive me Komisionin Evropian dhe rregullatorët e tjerë. TikTok është i kënaqur që ka arritur një zgjidhje miqësore", tha një zëdhënës i kompanisë.

TikTok mbetet nën hetim që kishte nisur që nga shkurti mes shqetësimeve se rrjeti social mund të mos jetë duke bërë mjaftueshëm për t'i trajtuar ndikimet negative të rinjtë.

TikTok është ndër 25 platformat "shumë të mëdha" në internet, përfshirë Facebook-un, Instagram-in dhe YouTube-n, të cilat duhet të jenë në përputhje me rregullat më të rrepta të DSA-së nga gushti i vitit 2023.

Rregullat, gjithashtu, presin që shitësit digjitalë me pakicë të veprojnë në mënyrë efektive për t'i mbrojtur blerësit në internet.

DSA i jep BE-së fuqinë për të gjositur kompanitë deri në gjashtë për qind të të ardhurave të tyre vjetore globale. Shkelësit e përsëritur mund të

shohin platformat e tyre të bllokuara në BE.

Hetimet po vazhdojnë për rrjetin social X, injohur më parë si Twitter, si dhe faqen kineze të shitjeve online AliExpress dhe kompaninë Meta, e cila përfshin Facebook dhe Instagram.

TikTok po përballet, gjithashtu, me një sërë problemesh përtej Atlantikut. Kompania kineze që zotëron TikTok-un, ka ngritur një padi për të ndaluar një ligj amerikan që kërkon që aplikacioni të shitet vitin e ardhshëm ose të përballet me një ndalim nga ShBA. ByteDance pretendon se kjo shkel të drejtën e Amendamentit të Parë për fjalën e lirë.

Shtetet e Bashkuara rritën presionin ndaj TikTok-ut javën e kaluar me një padi, duke akuzuar aplikacionin për shkelje të privatësisë së fëmijëve duke mbledhur të dhëna rreth tyre pa lejen e prindërve të tyre kur ata përdorin platformën.

TikTok tha se nuk pajtohet me pretendimet dhe se kompania ka masa mbrojtëse për të siguruar përvoja të përshtatshme për moshën.

## Irani thotë se nuk do përshkallëzim rajonal, por Izraeli "duhet të ndëshkohet"

**TEHRAN, 5 GUSHT** - Irani nuk po kërkon përshkallëzim të tensioneve rajonale, por beson se Izraeli duhet të ndëshkohet në mënyrë që të parandalohet paqëndrueshmëria e mëtejme. Kështu tha më 5 gusht zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, pasi javën e kaluar në Teheran u vra shefi politik i Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - Ismail Haniyeh. "Irani

kërkon të ketë stabilitet në rajon, por kjo mund të arrihet vetëm me ndëshkimin e agresorit dhe të krijohet parandalim kundër aventurizmit të regjimit zionist [Izraelit]", tha zëdhënësi Nasser Kanaani, duke shtuar se kundërpërgjigjja nga Teherani është e pashmangshme.

Kanaani i bëri thirrje Uashingtonit të mos e mbështesë më Izraelin, duke shtuar se komuniteti ndërkombëtar ka dështuar ta mbrojë stabilitetin në rajon dhe

duhet ta mbështesë "ndëshkimin e agresorit".

Edhe komandanti kryesor i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit, Hossein Salami, sërish tha të hënën se Izraeli "do të ndëshkohet".

Teherani dhe grupet e lidhura me Iranin, sikurse Hamasi dhe Hezbollahu, kanë akuzuar Izraelin për vrasjen e shefit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh. Zyrtarët izraelitë nuk kanë marrë përgjegjësinë për vrasjen.





## LV-ja: Kjo legjislaturë ka thyer rekord të miratimit të ligjeve

PRISHTINË, 5 GUSHT - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari, dhe deputeti Adnan Rrustemi kanë mbajtur të hënën konferencë për medie, në të cilën kanë shpalosur të arriturat dhe sfidat gjatë sesionit pranveror të Kuvendit. Kusari ka treguar se gjatë sesionit pranveror 2024 Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 23 seanca plenare, në të cilat janë miratuar 36

ligje, prej të cilave 20 marrëveshje ndërkombëtare. “Në Kuvendin e Kosovës janë miratuar 7 rezoluta, 1 deklaratë e përbashkët, 6 rekomandime, është miratuar statuti i Universitetit të Prishtinës, janë shqyrtuar 12 raporte vjetore, janë miratuar 4 raporte, 7 rezoluta për vlerësimin e punës vjetore të institucioneve që i raportojnë Kuvendit”, ka thënë ajo, duke shtuar se nga

14 komisione parlamentare, 7 prej tyre udhëhiqen nga LV-ja. “Janë mbajtur 186 mbledhje të komisioneve parlamentare me gjithsej 866 pika të trajtuara”, ka bërë me dije Kusari. Ndërkaq Adnan Rrustemi, deputet dhe kryetar i Komisionit për Legjislacion, ka thënë se kjo legjislaturë ka thyer rekord të miratimit të ligjeve në krahasim me të gjitha legjislaturat e mëparshme.



## Hoti: Mazhoranca mashtron lidhur me funksionimin e kësaj legjislature të Kuvendit të Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 GUSHT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se mazhoranca është duke mashtruar lidhur me funksionimin e kësaj legjislature të Kuvendit të Kosovës. “Si mund të jetë kjo legjislaturë më e suksesshme kur gjatë gjithë mandatit është cenuar demokracia parlamentare nga ana e mazhorancës?! Edhe kur është hedhur gaz lotsjellës, Kuvendi ka qenë më transparent e më efikas dhe ka marrë vendime kushtetuese e ligjore. Ky degradim i

punës së Kuvendit është cenim i demokracisë me pasoja të gjera për gjithë aparatit shtetëror dhe shtyllat e pushtetit”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Ai ka paraqitur disa fakte që dëshmojnë cenimin e demokracisë parlamentare gjatë kësaj legjislature, të konfirmuara nga organizatat që e përcjellin punën e Kuvendit. “1. Mbi 10 ligje e vendime janë shpallur antikushtetuese; 2. Mazhoranca e ka keqpërdorur mekanizmin e seancës së jashtëzakonshme për miratimin e pikave të rregullta të rendit të ditës, duke pamundësuar debatit dhe konsultimet publike; 3. Ka pasur tri raste kur Kuvendi ka



zhvilluar punimet pa e miratuar rendin e ditës; 4. Shumica parlamentare e ka pamundësuar funksionimin e Komisionit Hetimor

lidhur me rezervat shtetërore; 5. Çdo sesion i Kuvendit është mbyllur me dhjetëra pika të papërfunduara; 6. Ka pasur mungesë të thellë të

transparencës duke mos i publikuar materialet nga seancat dhe komisionet hetimore; 7. Nuk është funksionalizuar votimi elektronik, duke pamundësuar përcjelljen e votimit të deputetëve; 8. Qeveria ka injoruar Kuvendin të pyetjet parlamentare, të komisionet hetimore dhe të debatet parlamentare për të dhënë përgjigjësi për punën e vet dhe për programin qeverisës;

9. Ka pasur mungesë kronike të kuorumit që në shumicën e rasteve është shkaktuar nga deputetët e mazhornacës; 10. Mazhoranca nuk ka bashkëpunuar me opozitën as në miratimin e ligjit për buxhetin, e lëre më në ligjet e tjera”, ka shkruar Hoti.

## Tahiri: Shumica parlamentare e ka tradhtuar skajshmërisht besimin qytetar

PRISHTINË, 5 GUSHT - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-së), Besnik Tahiri, në një konferencë për medie ka folur për dështimet e këtij sesioni parlamentar. “Për grupin parlamentar të AAK-së ky sesion parlamentar ka qenë shumë dinamik, dhe në qoftë se vlerësohen të dhënat numerike nga raportet e OJQ-ve profesionale që e vlerësojnë punën e partive politike, shihet që AAK-ja ka qenë grupi parlamentar më aktiv në këtë sesion”, ka thënë ai.

Tahiri ka shtuar se ky sesion nuk ka qenë i lehtë për shkak se shumica parlamentare ka vazhduar në masë më të madhe se viteve të tjera ta shpërfaqë arrogancën e vet



të numrave me qasjen autoritare, duke mos dhënë llogari dhe përgjegjësi në raport me besimin. “Shumica parlamentare e ka tradhtuar skajshmërisht besimin

qytetar që e ka marrë me mbi 50 %, duke e pamundësuar punën e rregullt të Kuvendit të Kosovës dhe duke abstraktuar me metoda të ndryshme. Kjo shumicë

parlamentare dhe kjo qeveri nuk e kanë marrë mundin të përgjigjen në pyetjet parlamentare të ngritura nga opozita. Në histori të të gjitha qeverive, kjo qeveri e përfaqësuar nga kjo shumicë është qeveria më jotransparente, ndërsa shumica parlamentare më jollogaridhënëse ndaj besimit qytetar. Po ashtu, kjo shumicë nga 12 qershorit nuk ka mbajtur sesion plenar”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se ky Kuvend dhe kjo shumicë parlamentare e kanë trajtuar në aspektin e njëanshëm të gjithë politikën që lidhet me temat e konsensusit në këtë institucion.

“Kjo shumicë parlamentare e ka një besim historik të qytetarëve të Kosovës, po ashtu në historinë e

qeverisjes është dështimi më i madh historik duke mos arritur për katër vjet asnjë projekt të vetëm ta realizojë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Pse? 1. Kosova është e bllokuar gjithandej me rrugët e veta, 2. Ekonomia para kolapsi, 3. Marrëdhëniet me ShBA-në janë në nivelin më të ulët, ndërsa 4. Shteti ynë është nën sanksione ekonomike dhe politike nga Bashkimi Evropian. Në sesionin e vjeshtës, si grup parlamentar, zotohemi të përmbush të gjitha përgjegjësitë që i ka, për të ballafaquar qytetarin e Kosovës me të vërtetën, njëkohësisht për të ballafaquar këtë qeveri më dëmet që i bëri Kosovës”, ka thënë Tahiri.

## Deputeti i LV-së: Presidentja ka më shumë se një muaj në dispozicion për konsultimin e datës së zgjedhjeve

PRISHTINË, 5 GUSHT - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, ka thënë të hënën, në një konferencë për medie, se presidentja Vjosa Osmani do t'i vazhdojë konsultimet për caktimin e datës së zgjedhjeve. Ai ka thënë se presidentja ka më shumë se një muaj në dispozicion për t'u konsultuar për këtë çështje. “Konsultimet do të

vazhdojnë sepse ka afat ende në këtë drejtim. Kam qenë për një kohë të gjatë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Presidentja ka më shumë se një muaj në dispozicion për t'i zhvilluar konsultimet deri në caktimin e datës së zgjedhjeve e cila natyrisht nuk duhet të jetë më vonë se katër muaj para datës së caktuar e cila mund

të jetë natyrisht me katër datat e paralajmëruar tashmë”, u shpreh ai. “Rregullimi kushtetues ka përcaktuar 60 ose 30 ditë më herët para përfundimit të mandatit, që nënkupton prej 26 janarit deri më 16 shkurt janë datat e mundshme për t'u caktuar si datë e zgjedhjeve”, ka theksuar Rrustemi.







KURTI NË SHKUP: DUAM TË KEMI MARRËDHËNIE TË MIRA FQINJËSORE ME MAQEDONINË E VERIUT

## Kryeministri Albin Kurti me tre ministra të hënën ka vizituar Maqedoninë e Veriut

Kryeministri Albin Kurti, pas takimit me homologun maqedonas Hristijan Mickoski, ka thënë se Kosova dëshiron të ketë marrëdhënie të mira fqinjësore me Maqedoninë e Veriut. Ai ka thënë se janë mirënjohës për kontributin e kontingjentit ushtarak paqeruajtës të trupave të Maqedonisë së Veriut në kuadër të KFOR-it duke përkrahur përpjekjet për një mjedis të sigurt, paqësor dhe stabil për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kryeministri Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, ka thënë se si qeveri e re kanë synim të ndërtojnë marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët. Të dy kryeministrat theksuan nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

SHKUP, 5 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti me tre ministra ka vizituar të hënën Maqedoninë e Veriut. Ai është pritur nga homologu Hristijan Mickoski. Kjo vizitë në Shkup e Kurtit u zhvillua në kohën kur raportet u acaruan për shkak të incidentit që i ndodhi ditë më parë presidentes Vjosa Osmani në Aeroportin e Shkupit.

Pas takimit të dy kryeministrat kanë mbajtur një konferencë për medie, ku theksuan se mbesin të përkushtuar për t'i vazhduar marrëdhëniet e mira fqinjësore. "Dëshiroj ta shpreh falënderimin për këtë takim të hapur, të sinqertë e serioz, që zhvilluam ne si dy kryeministra të republikave tona, Republikës së Kosovës dhe

Republikës së Maqedonisë së Veriut, por edhe me delegacionet tona, meqenëse kishim një mori temash e çështjesh të cilat i diskutuam e që padyshim se janë për të mirën e dyanshme e të përbashkët. Unë isha së bashku me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dhe me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, përveçse me këshilltarë dhe me ambasadorin tonë të nderuar këtu, Florian Qehaja. Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut kanë marrëdhënie të mira bilaterale, të bazuara në vlera të përbashkëta dhe me synim të qartë për integrim evropian", ka

thënë Kurti. Ai ka thënë se vlerësojnë përpjekjet e vazhdueshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim në Bashkimin Evropian dhe ka uruar që sa më parë të jetë e mundur t'i fillojnë negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Maqedonia e Veriut, fqinja jonë, është vend anëtar i NATO-s. Ne jemi mirënjohës për kontributin e kontingjentit ushtarak paqeruajtës të trupave të Maqedonisë së Veriut në kuadër të KFOR-it duke përkrahur kështu përpjekjet për një mjedis të sigurt, paqësor dhe stabil për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor", është shprehur Kurti. Ai ka shtuar se të dyja vendet tona kanë bashkëpunim bilateral në çdo fushë. "Në aspektin

diplomatik, ne përshëndesim përkrahjen e vazhdueshme të Maqedonisë së Veriut në përpjekjet tona për integrim në organizata ndërkombëtare, e sidomos në Këshill të Evropës dhe në NATO. Ne synojmë fuqizimin e bashkëpunimit në kuadër të Procesit të Berlinit, platformë kjo e vetmja gjithëpërfshirëse rajonale me përfitues përfundimtarë qytetarët e rajonit. Në aspektin ekonomik e të tregtisë, siç e tha edhe kryeministri Mickoski, e kemi ngritur shkëmbimin tregtar, në një vlerë prej rreth gjysmë miliardi euro, dhe në këtë bashkëpunim ka edhe investime reciproke në të dyja vendet, ndërkohë që ky gjysmë miliardi euro është në ngritje e sipër për shkak se kemi edhe trend pozitiv. Maqedonia e Veriut tash e disa vjet është vendi ku eksportojmë shumë mallra të Kosovës në vlerë të lartë, edhe një e dhënë tjetër e cila është në ngritje e sipër", ka theksuar Kurti, duke shtuar se në këtë dyfishim të eksporteve të Republikës së Kosovës në përgjithësi një pjesë e konsiderueshme është ngritja e eksporteve pikërisht në Maqedoninë e Veriut. "Në aspektin e sigurisë dhe të mbrojtjes ne vijojmë të kemi bashkëpunim të mirë. Mezi

presim që të operacionalizohen pikat e përbashkëta kufitare, sidomos kjo në Hanin e Elezit e në Bllacë, të cilat do të lehtësojnë qarkullimin edhe ashtu në rritje të qytetarëve tanë. Ne të gjithë e dimë se kemi shumë familje e farefis në të dy anët e kufirit. Madje edhe zëvendësja ime, ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, vjen nga Shkupi si vendlindje, edhe nëna e saj është nga Shkupi, siç është edhe nëna e kryeparlamentarit, Glauk Konjufca", është shprehur kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se janë të interesuar, siç tha edhe kryeministri Mickoski, që të kemi sa më shumë qarkullim të lirë midis qytetarëve, dhe për këtë padyshim është rruga e cila e lidh kufirin e Kosovës me Shkupin, kur të rregullohet e të lëshohet në përdorim, do të ndihmojë jashtëzakonisht shumë. "Ne përkrahim fuqizimin edhe më tej të bashkëpunimit në sferën e mbrojtjes posaçërisht në raport me zbatimin e marrëveshjes ekzistuese bilaterale ushtarake. Republika e Kosovës pret të ndërtojë edhe më shumë ndërlidhje transporti rrugor e hekurudhor me Maqedoninë e Veriut në funksion të lehtësimit të qarkullimit të njerëzve dhe të



# Neziri: Incidenti në aeroport nuk do t'i rrënojë raportet në mes të Prishtinës dhe Shkupit

PRISHTINË, 5 GUSHT - Njohësi i zhvillimeve politike, Xhelal Neziri nga Maqedonia e Veriut, tha se në konferencën për medie të Kurtit dhe Mickoskit u pa se incidenti në Aeroportin e Shkupit nuk ka ndikuar negativisht në raportet e mira në mes të Maqedonisë së Veriut me Kosovën. "Mendoj se është sqaruar ky incident me presidenten Osmani, në kuptimin se nuk ka qenë i qëllimshëm apo nuk ka qenë provokim nga Shkupi zyrtar. Po ashtu, duket se është sqaruar edhe çështja e asaj që është e vërtetë, a është e vërteta ajo që është thotë kabineti i presidentes apo atë që e thonë institucionet e Maqedonisë së Veriut. Dhe, si

duket, ka një marrëveshje që të pritet raporti përfundimtar i hetimit që do ta bëjnë autoritetet kompetente në Maqedoninë e Veriut", tha Neziri për "Radion Evropa e Lirë". "Nëse rezulton se ndonjëri nga zyrtarët e sigurisë së Aeroportit ka përgjegjësi për incidentin, si duket ai do të mbajë përgjegjësi për këtë veprim", shtoi ai.

Sipas Nezirit, faktori i parë që ka mundur ta shkaktojë incidentin është që edhe vetë zyrtari i Aeroportit të Shkupit të jetë motivuar politikisht apo etnikisht që të shkaktojë një incident të tillë për shkak se, sipas tij, me siguri e ka njohur presidenten e Kosovës. Ose një

variant tjetër, sipas tij, mund të jetë se e gjithë kjo ngjarje është një keqkuptim lidhur me protokollet e sigurisë që duhet të ndiqen për personat që kalojnë përmes terminalit VIP.

Neziri konfirmoi se në Maqedoni të Veriut po zhvillohet një debat i ashpër politik sa i përket këtij incidenti. Opozita shqiptare ka kritikuar qeverinë, duke e akuzuar për tendencë ndaj presidentes Osmani. Debat, po ashtu, është ndezur edhe për faktin se për herë të parë pjesë e qeverisë maqedonase është Ivan Stoikoviç, mik i Beogradit dhe Moskës, dhe një person që hapur është shprehur kundër Kosovës. Pastaj, sipas Nezirit, ky

debat u kurorëzua në atë mënyrë që qeveria maqedonase të portretizohet si antikosovare. "Prandaj, edhe reagimi i qeverisë maqedonase ishte pikërisht në atë kontekst: të mos tregojë frikë dhe nënshtrim për atë që ndodhi në Aeroportin e Shkupit", tha Neziri.

Lidhur me reagimin e partive shqiptare - që e kanë dënuar incidentin, por kanë fajësuar njëra-tjetrën për të - Neziri tha se ka kohë që raportet e tyre janë të armiqësura dhe çdo rast ato e përdorin për të këmbyer akuza, sikurse ndodhi edhe për ngjarjen e 1 gushtit. "Është një luftë e ashpër që ndodh mes partive politike shqiptare. Është BDI dhe Fronti

Evropian si koalicion opozitar që akuzon koalicionin VLEN, që është pjesë e qeverisë, si një përfaqësues jolegjitim i shqiptarëve për shkak se mori më pak vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Dhe ky debat mbi legjitimitetin ka prodhuar krizë të paparë në marrëdhëniet në mes të partive politike këtu. Incidenti u përdor apo u keqpërdor pikërisht në këtë kontekst, legjitimiteti dhe fuqia politike që mund të ketë VLEN-i për t'i përfaqësuar shqiptarët në këtë qeveri", tha ai.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë raporte diplomatike dhe deri më tani nuk kanë pasur incident të kësaj natyre.



mallrave. E ritheksojmë faktin dhe vlerën se Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet anëtar i NATO-s, i kësaj aleance të vendeve demokratike, ushtarakisht më e fuqishmja jo vetëm në botë, por edhe në historinë e njerëzimit. Ne duam të kemi marrëdhënie të mira fqinjësore dhe evropiane edhe si shtete, edhe si popuj. Ne do të punojmë së bashku me qeverinë e re në funksion të fuqizimit edhe më tej të bashkëpunimit bilateral bazuar në mirëbesim dhe në interesin reciprok", ka thënë Kurti.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, tha se me Kurtin patën një takim konstruktiv në një atmosferë miqësore, duke hapur të gjitha çështjet që janë të rëndësishme për marrëdhëniet mes dy vendeve dhe dy qeverive. "Është diçka thelbësore për ne. Si qeveri e re, synimi ynë është të ndërtojmë marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët tanë, në parimin e rrugës së dyanshme. Gjithashtu,

theksuam nevojën e rritjes së bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, gjë që është shumë e

rëndësishme", ka thënë Mickoski.

Interesimi i medieve ishte edhe për incidentin në Aeroportin e Shkupit që i ndodhi ditë më parë presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. Mickoski ka bërë të qartë se nuk dëshiron që incidente të tilla të përsëriten, teksa shtoi se dy shtetet kanë raporte të mira.

Kryeministri maqedonas ka pohuar se herën tjetër kur Osmani ta përdorë Aeroportin e Shkupit për udhëtime, ai personalisht do ta shoqërojë "deri në momentin kur të largohet". Ai,

po ashtu, ka thënë se autoritetet e Aeroportit në Shkup aplikojnë masa standarde të sigurisë sa iu përket fluturimeve komerciale.

Kurti ka thënë se gjatë takimit autoritetet maqedonase shprehën sërish keqardhje për ngjarjen ku u përfshi Osmani. "Ka qenë përvojë dhe përjetim i rëndë i presidentes Osmani më 1 gusht, aq më tepër që ishte me dy vajzat e vogla", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se po pret një raport, pas hetimit zyrtar, që do të zbardhë të gjithë atë që ka ndodhur. "Do të ketë një raport zyrtar që do ta zbardhë këtë

çështje në tërësi, që të kuptojmë se çfarë saktësisht ka ndodhur, por edhe që të mos na përsëriten më kurrë situata të tilla", është shprehur Kurti.

Kryeministri Kurti u pyet nëse Kosova mban qëndrimin se kjo ngjarje ishte provokim. Por, Kurti tha se nuk e di që institucionet kanë pasur një qëndrim të tillë dhe këtë mund ta ketë thënë ndonjë "qytetar", por jo edhe institucionet e Kosovës, duke theksuar se Ministria e Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës përmes njoftimeve ka shprehur qëndrimin e qeverisë.



## Ministria e Bujqësisë investon në 9 000 metra kanal për ujitjen e tokave bujqësore në Deçan

DEÇAN, 5 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se fshati Isniq është vend i bukës e i traditës ndër breza, e në këtë frymë ai ka bërë me dije

se ministria që drejton ka investuar në 9 000 metra kanal për ujitjen e tokave bujqësore në vlerë prej 346,956 eurosh. “6 000 hektarë e kanë tashmë

mundësinë e qasjes në sistemin e ujitjes. Segmenti përfshin tokat e Deçanit, Isniqit, Llukën e Epërme dhe Llukën e Ulët. Ky projekt është një hap i

rëndësishëm për përmirësimin e bujqësisë dhe rritjen e prodhimitarisë në komunën e Deçanit”, ka shkruar ministri Peci në “Facebook”.



## Policia sekuestron tetë armë zjarri në Prishtinë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Nga zyrtarët policorë të rajonit të Prishtinës gjatë javës së kaluar në lokacione të ndryshme e aksione të ndara janë realizuar 129 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 41 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Konform urdhëresave, pas përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi kanë kryer obligimet e caktuara

në urdhëresa. Ndërkohë që aktivitetet policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. Gjatë periudhës së njëjtë janë sekuestruar 8 armë zjarri, të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm. Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor, në po të njëjtën periudhë kohore, kanë rezultuar me shqiptimin e 4 219 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor.

## Policia ndan mirënjohje për drejtorin e ShSKUK-së

PRISHTINË, 5 GUSHT - Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, zëvendës-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, në emër të drejtorit të përgjithshëm, Gazmend Hoxha, ka ndarë “Mirënjohje” për drejtorin e ShSKUK-së, Elvir Azizi. Ky çmim u dha për bashkëpunimin dhe kontributin e tij në implementimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ShSKUK-së dhe

Policisë së Kosovës (PK) për ofrimin e shërbimeve mjekësore për personelin policor. Mirënjohje janë ndarë edhe për Osman Hajdarin, drejtor i QKUK-së dhe Gëzim Murselin, drejtor i Qendrës Kombëtare Sportive. Këto mirënjohje janë shprehje e vlerësimit për punën dhe angazhimin e tyre të veçantë për përbushjen e objektivave të përbashkëta dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore për zyrtarët policorë.



## Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka ndaluar nëntë persona



GJILAN, 5 GUSHT - Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës, nga data 29 korrik 4 gusht, ka ndaluar nëntë persona për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra të ndryshme penale. Një person është ndaluar për veprën penale “Sulmi ndaj personit zyrtar, një person për veprat

penale “Kanosja” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, një person për veprën penale “Mashtrimi”, gjashtë persona, në katër raste të ndara për veprën penale “Dhuna në familje”. Prokuroria Themelore në Gjilan ndaj personave të ndaluar ka

parashtruar kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore në Gjilan. Gjithashtu, gjatë kësaj jave është raportuar një rast “Vdekje e dyshimtë” në fshatin Shillovë, për të cilën prokurori kujdestar ka dhënë urdhër që trupi i pajetë të dërgohet për autopsi.

## Latifi mban mbledhjen e radhës me drejtorë të drejtorive, diskutohet për ecurinë e punëve

RAHOVEC, 5 GUSHT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur mbledhjen e

përjavshme me drejtorët e drejtorive. Ai gjatë kësaj mbledhje ka biseduar me

drejtorët e drejtorive për ecurinë e punëve, sfidat në zbatimin e projekteve dhe

planet e mëtejme për rritjen e mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.





# Abdixhiku viziton minatorët e mbetur pa paga: I mbështesim plotësisht kërkesat e tyre

“Minatorët e Trepçës po futen në muajin e tretë pa paga. Në ditën e 27 të ndaljes së punës nga ta, qëndrova në Trepçë. Vizitova dhe pashë kushtet jo vetëm të rënda të punës, por antihumane. Aq antihumane sa nuk i besoni pa i parë vet aty! Por sot kushtet, pajisjet primitive, që datonin, besoni ose jo, që nga viti 1919, sot janë në rend të dytë”, ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se janë në rend të dytë sepse plot 1 100 punëtorë të Trepçës janë pa paga dhe po futen në muajin e tretë pa asnjë pagë kompensim

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**MITROVICË, 5 GUSHT** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Adbixhiku, i ka takuar të hënën minatorët në minierën e “Trepçës”, të cilët ka gati një muaj që e kanë ndaluar punën pasi kanë mbetur pa paga nga qershori.

Abdixhiku u takua me kryetarin e Sindikatës së Minatorëve,

Ibrahim Januzi dhe me minatorët të cilët tha se ka hezituar t'i takojë deri tash “me shpresën se çështja do të zgjidhej pa komplikim”. “Minatorët e Trepçës po futen në muajin e tretë pa paga. Në ditën e 27 të ndaljes së punës nga ta, qëndrova në Trepçë. U prita dhe nga kryetari i Sindikatës së Minatorëve, Ibrahim Januzi, e nga Kryesia e kësaj sindikate. Kam hezituar t'i takoj me

shpresën se çështja do të zgjidhej pa komplikim. Çdo involvim yni partiak bartte rrezikun e politizimit të kauzës së tyre. Por neglizhenca institucionale, e shtetit, e qeverisë popullsite, e vargut të gjatë të atyre përfituesve që Trepçën e minatorët i përdorin si pamflet elektoral njëpërdorimësh, ka bërë observimin tonë të duket i pakuptimtë. Prandaj sot qëndrova me ta. I dëgjova nga afër. Vizitova dhe pashë kushtet jo vetëm të rënda të punës, por antihumane. Aq antihumane sa nuk i besoni pa i parë vetë aty! Por sot kushtet, pajisjet primitive, që datonin, besoni ose jo, që nga viti 1919, janë në rend të dytë”, ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se janë në rend të dytë sepse plot 1 100 punëtorë të Trepçës janë pa paga dhe po

futen në muajin e tretë pa asnjë pagë kompensim. “Punëtorët janë të Trepçës. Trepça është e shtetit. Ata kanë kontrata, kanë zotim shtetëror për pagën që duhet marrë. Partia në pushtet menaxhon me kompleks me Borde e me Menaxhment. Është përgjegjësi e tyre, e shtetit, që punëtorët e vet t'i kompensojë për punën dhe kontratën që kanë. Prandaj, i mbështesim në plotni kërkesat e tyre. I mbështesim në plotni dhe lutjet për kushte më njerëzore e kërkesat për investime afatgjata në kompleks që sot xehet e Kosovës në vend se ti shet në materiale të përpunuara i shtet si koncentrat me shumë më pak vlerë”, ka thënë ai.

Lideri i LDK-së ka theksuar se minatorët, në përballje me popullistë, rrezikohen të quhen

dhe tradhtarë. “Deputetë e pushtetarë, që këtë muaj tashmë i kanë marrë pagat nga 2000 euro, nuk do të pritojnë që mesazhet e gatshme nga ‘Politbyroja e Tiranës’ t'i drejtojnë nga Minatorët. Siç kanë bërë më çdo vlerë në këtë vend, me aleat, mësues, mjek, patriot e atdhetarë, luftëtarë e veprimtarë, dhe minatorët kanë të njëjtin fat. Fati i popullistëve është i shkurtër megjithatë. Dhe për dallim nga terri i ndershëm i minatorëve, aty ku këta burra plakin një të tretën e jetës, terri i përfundimit popullist do të jetë i padenjës. Sepse Kosova është më e fortë se kaq. Populli i Kosovës është më i mençur se çfarë popullistët ndarës e përçarës kanë në mend. Kosova meriton më mirë! Minatorët meritojnë zgjidhje pa hezitim!”, ka deklaruar Abdixhiku.



## Aksion policor në objektet e Postës së Serbisë në veri të Kosovës

**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Policia e Kosovës ka konfirmuar të hënën për Radion Evropa e Lirë se është duke u zhvilluar një aksion policor në veri të vendit, përkatësisht në objektet e Postës së Serbisë. Një punonjës i Postës në Zveçan i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se zyrtarët policorë e kanë bllokuar hyrjen e objektit dhe ata nuk mund të hyjnë më aty. Sipas tij, gjatë aksionit zyrtarët policorë kanë kontrolluar dokumente.

Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë se aksioni ka nisur pas informatës së pranuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), se në territorin e Kosovës po operojnë operatorë ekonomikë pa licencë dhe që nuk janë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). “Informacioni ka



rezultuar të jetë i saktë, me ç'rast policia ka njoftuar Prokurorin e Shtetit dhe tutje vazhdojmë sipas autorizimeve të tij”, është thënë në përgjigje.

Kryetari i ARKEP-it, Nazim Rahimi, ka konfirmuar për “Radion Evropa e Lirë” se institucioni që udhëheq ai i ka

njoftuar “institucionet relevante të Kosovës se Posta e Serbisë është duke operuar në mënyrë ilegale në territorin e Kosovës”. Megjithatë, ai nuk ka treguar numrin e zyrave të Postës së Serbisë që operojnë në Kosovë. “Ne mbulojmë vetëm pjesën e domenit të shërbimeve postare,

ofrimin e shërbimeve të postës, të letrave dhe pakove”, ka thënë ai.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është organ rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit.

Posta e Serbisë në Kosovë kryen pagesa të ndryshme për serbët në Kosovë, prej fondeve që ndan qeveria serbe për ta, përfshirë: pagat, shtesat për fëmijë dhe pensionet. Gjithashtu, përmes Postës së Serbisë, në Kosovë kryhen edhe pagesa të ndryshme për shërbimet që marrin qytetarët nga institucionet paralele, që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë, për shembull, pagesa për nxjerrjen e

dokumenteve serbe, pagesa për provime, dërgesa të parave e të tjera.

Përveç komunave në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - Posta operon edhe në zonat e banuara me serbë në jug të Ibrit. Puna e Postës është vështitësuar prej fillimit të këtij viti për shkak të një vendimi të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i cili e ka bërë euron valutë të vetme për kryeje të pagesave me para të gatshme.

Kështu, është ndaluar përdorimi i dinarit serb.

Serbia pretendon se ndan ndihmë në vlerë të miliona eurove për banorët serbë në Kosovë.

Mekanizmi ndërkombëtar pati kritikuar autoritetet e Kosovës për marrjen e këtij vendimi, duke thënë se nuk kanë ofruar alternativa të mjaftueshme për serbët lokalë.



## Balkani Perëndimor, plane të mëdha për projekte diellore dhe të erës

PRISHTINË, 5 GUSHT - Vendet e Ballkanit të Perëndimor po synojnë të realizojnë projekte të mëdha të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet diellore dhe të erës. Realizimi i këtyre projekteve në Kosovë, Serbi, Mal të Zi,

Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë do të ndikonte të shmangeshin mbi 100 milionë tonë emetim të dyoksidit të karbonit si dhe ta ulte nevojën për prodhim të energjisë nga gazi.



Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet diellore dhe të erës është tejet i ulët në të gjithë Ballkanin Perëndimor, shkruan REL. Aktualisht vetëm 7 për qind e energjisë elektrike në këtë rajon gjenerohet nga burimet

e ripërtërishme diellore dhe të erës. Më shumë se 90 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga djegia e qymyrit, rreth 4 për qind nga hidrocentralet dhe pjesa tjetër nga burimet e erës dhe ato diellore.

## Caktohet marzha tregtare për produktet e naftës dhe forcohet mbikëqyrja e cilësisë dhe sasisë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka evidentuar mospërshtatje të çmimeve vendore të produkteve të naftës në krahasim me lëvizjet e çmimeve në tregun botëror. Kjo evidencë rezultoi nga monitorimi i rregullt i tregut të produkteve të naftës, raporti i Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut lidhur me çmimet e shitjes me pakicë të produkteve të naftës, si dhe njoftimet ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës lidhur me çmimet e furnizimit/importit të

produkteve të naftës. Evidenca në fjalë sjell një bazë/shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e konkurrencës dhe për t'i mënjeluar çrregullimet në treg, MINT ka marrë vendim për caktimin e çmimit dhe masave të tjera mbrojtëse të produkteve të naftës.

Sipas këtij vendimi, marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është 2 euro centë për litër, kurse marzha



tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është 12 euro centë për litër.

Llogaritja e marzhës tregtare

maksimale e lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2. të U/A nr. 03/2022 për Rregullimin e

Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Ky vendim mbetet në fuqi tridhjetë ditë.

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij vendimi bëhet nga Inspektorati Qendror i Tregut në bashkëpunim me Doganën dhe Administratën Tatimore. Me këtë rast, MINT njofton se Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut në ditët në vijim do ta forcojë mbikëqyrjen e tregut edhe sa i përket cilësisë dhe sasisë së produkteve të naftës.

## Rritet indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore në tremujorin e parë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e parë (TM2) 2024. Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Në TM2 2024 indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rënë

për (-5.4 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 5,7 %. Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 0.2, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe:

drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.



## Hoti kritikon qeverinë Kurti: Në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë realizuar vetëm 21 % e investimeve kapitale



PRISHTINË, 5 GUSHT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se me qeverisjen Kurti nuk ka zhvillim. Sipas Hotit, në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë realizuar vetëm 21 % e investimeve kapitale. "Me këtë qeverisje, vetëm zhvillim nuk ka. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë realizuar vetëm 21 % e

investimeve kapitale. Qindra projekte të parapara në buxhet nëpër ministri të ndryshme nuk kanë nisur të realizohen. Raporti gjashtëmujor i buxhetit vërteton se edhe sivjet po vazhdon trendi i tri viteve të kaluara, ku buxheti për projekte kapitale kalon në suficit. Tani është e sigurt se ky mandat qeverisës do të mbyllet me

dështim të plotë në investime kapitale. Një ekonomi ku nuk ka investime të mjaftueshme kapitale, publike dhe private, nuk ka zhvillim. Kur nuk ka investime, jo vetëm që nuk shtohet kapitali prodhues, por vjetërsohet dhe bëhet i papërdorshëm edhe kapitali ekzistues", ka shkruar Hoti në "Facebook".

## Hapet thirrja për programin "Praktikë në qeveri"


PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hapur programin "Praktikë në qeveri" për punë praktike me pagesë për 6 muaj në institucionet e nivelit qendror. Të drejtë aplikimi kanë të rinjtë deri në moshën 29-

vjeçare; në vitin e fundit të studimeve apo të diplomuar në Bachelor apo Master (drejtimet e specifikuar në shpallje), me notë mesatare në studime mbi 8.0.

Aplikacioni duhet ta përmbajë titullin në email (subject line) që specifikon institucionin ku

aplikoni për praktikë në punë, dëshminë mbi notën mesatare apo diplomën, kopjen e letërnjoftimit.

Aplikacionet dërgohen në email sipas listës së bashkëngjitur në thirrje. Afati i fundit për aplikim: 9 gusht 2024.





# Evropa midis Trump dhe Harris



**Angelo PANEBIANCO**

**Rikthimi i historisë.** Udhëheqësit evropianë po mbajnë gojën mbyllur, por të gjithë po mbajnë frymën. A do të fitojë Kamala Harris në zgjedhjet presidenciale të nëntorit apo do të fitojë Donald Trump? Pasiguria është maksimale, la hipoteza për një përplasje deri në votën e fundit. Fati i Evropës (si dhe, padyshim, i pjesës tjetër të botës) mund të varet nga një grusht konsensusesh elektorale në ato pak shtete amerikane. Skenari i parë: fiton Kamala Harris. Evropa merr frymë e lehtësuar. Vazhdimësia shpërblehet. Nuk priten dallime të mëdha midis qëndrimit ndërkombëtar të administratës Biden dhe asaj të një administrate hipotetike të Harris. Ukraina do të vazhdojë të gëzojë ndihmën amerikane, NATO nuk do të humbasë funksionin e saj si zamka ushtarake e botës përëndimore. Por çdo medalje ka anën e saj negative. Lehtësimi nga disfata e Trump mund t'i bëjë evropianët të harrojnë faktin se Amerika nuk është më ajo që ishte dikur, se skurrja e ekspozimit të saj ndërkombëtar

filloi me presidencën e Barack Obamës (sponsor i Harrisit). Harris apo Trump nuk bën dallim: Prioriteti strategjik i SHBA-së sot është frenimi i Kinës. Konkurrenca në Azi do të ketë ende përparësi edhe me një administratë demokratike, krahasuar me atë që ndodh në fusha të tjera. Një komentator i famshëm amerikan, Walter Lippmann, argumenton se sekret i politikës së jashtme qëndron në ruajtjen e një ekuilibri midis angazhimeve ndërkombëtare dhe burimeve në dispozicion. Në një fazë të rënies relative të fuqisë amerikane, burimet në dispozicion të Shteteve të Bashkuara janë tkurrur dhe angazhimet duhet të zvogëlohen. Edhe me një administratë Harris, Evropa nuk do ta humbiste nevojën për të bërë shumë më tepër sesa bën sot për sigurinë e saj. Megjithatë, euforia për humbjen e Trumpit, ndjenja e shpëtimit nga rreziku, mund t'ua heqë qartësinë evropianëve dhe t'i bëjë ata të shtynë në kohë vendime që do të ishin të kushtueshme politikisht. Skenari i dytë: fiton Trump. Një cunam. Në Ukrainë, lufta mund



të përfundonte sipas kushteve të Putinit. NATO do të ishte në krizë. Trump nuk e ka fshehur kurrë se i konsideron evropianët jo një burim, por një klub parazitësh. Në Evropë, fitorja e Trump do të nxiste rrymat antiperëndimore (pro-putiniste). Armiqtë e Perëndimit, Rusia, Kina, Irani, xhihadistët nga çdo pjesë e botës islame, do të vinin re me kënaqësi se Evropa është e dobët, në vështirësi, me fytyrë zbuluar. Një objektivi i lehtë. Për arsyt e sipërpërmendura, me fitoren e Trump, paniku do të përhapet nëpër Evropë. Dhe paniku ndonjëherë të shtyn të bësh zgjedhjet e duhura. Në këtë rast, zgjedhja e duhur do të ishte forcimi i kohezionit të Evropës. Mbi të gjitha, duhet kaluar nga fjalët në vepra në çështjet e mbrojtjes evropiane: ndërtimi i "këmbës evropiane" të famshme të NATO-s me shpresën se, NATO do të jetë në gjendje t'i mbijetojë edhe Trumpit. Por ndonjëherë paniku nuk të shtyn të bësh zgjedhjet e duhura. Nën moton "çdo njeri për veten e vet", evropianët nuk mund të lëviznin veç e veç, secili duke kërkuar shpëtimit e vet. Megjithatë, një gjë është e sigurt. Duke pasur parasysh mosinteresimin dhe

përbuzjen e Trump për marrëveshjet shumëpalëshe, qeveritë evropiane do ta gjenin veten të detyruar të negocionin, secila në emër të vet, kushtet e marrëdhënieve të reja me Shtetet e Bashkuara. Mund të vëmë bast se Trump do të "shpërthente" autoritetet e Brukselit dhe do të pranonte të merrej vetëm me qeveritë kombëtare. Për shembull, Italia duhet të negociojë individualisht me administratën amerikane për mosmarrëveshjet e shumta ekonomike. Mbi të gjitha, duke qenë se rreziqet më të mëdha për Italinë vijnë nga bregu jugor i Mesdheut, Italia duhet të përpiqet t'i marrë Trumpit premtim për mbulim dhe mbrojtje maksimale ushtarake në këtë zonë. Është e qartë se qeveritë evropiane, edhe pse (me të drejtë) nuk e thonë hapur, janë më mirë nëse fiton Harris, por ata gjithashtu e dinë se do të duhet të marrin parasysh fitoren e mundshme të Trump. Harris mund të fitojë ose Trump mund të fitojë. Por ka edhe një skenar të tretë të mundshëm. Kamala Harris fiton me një diferencë të ngushtë dhe Trump nuk e pranon humbjen. Pason

një periudhë trazirash dhe dhune. Me paturpësinë e tij tradicionale, Trump mund të denoncojë zgjedhjet e manipuluar, ndoshta duke përmendur rastin e Venezuelës (ku mashtrimi ndodhi në të vërtetë). Një Amerikë në grahamat e trazirave do të ishte, para se të rivendosej qetësia dhe rendi, ndërkombëtarisht shumë e dobët. Dhe shumë, në mbarë botën, do të përfitonin nga kjo. Edhe në rastet më të favorshme, d.m.th., nëse fiton Harris, evropianët do të duhet të bëjnë më shumë për të siguruar veten. Nëse politika do të ishte një lojë e dominuar vetëm nga llogaritjet racionale, lojtarët evropianë do ta dinin se çfarë duhej bërë dhe do ta bënin. Por në politikë llogaritjet racionale duhet të përballen gjithmonë me pasionet, paragjykimet, dembelizmin mendor, pikëpamjet e shtrembëruara të fakteve, mbrojtjen e gjithanshme të interesave afatshkurtra edhe nëse kjo komprometon interesat afatgjata. Gjithmonë ka një hendek midis asaj që duhet bërë dhe asaj që mund të bëhet.

/ Corriere della sera b





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## MKRS-ja sonte organizon pritje shtetërore për ekipin olimpik

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sonte (e martë, 6 gusht) do të organizojë pritje shtetërore për nder të kampionëve dhe ekipit olimpik të cilët e kanë përfaqësuar Kosovën me

krenari në Lojërat Olimpikë në "Paris 2024". "Kjo mbrëmje i dedikohet festimit të arritjeve të tyre të jashtëzakonshme, punës së palodhur dhe medaljeve historike që kanë sjellë në

shtëpi. Sportistët tanë i kanë treguar botës fuqinë, vendosmërinë dhe talentin e Kosovës, duke na bërë të gjithëve krenarë. Bashkohuni me ne në sheshin 'Xhorxh Bush', t'i presim me krahë

hapur e ta festojmë suksesin e tyre së bashku", thuhet në njoftimin e ministrisë. Ngjarja do të mbahet në Sheshin "Xhorxh Bush" në Prishtinë me fillim nga ora 19:00.



## Ndërroi jetë Izet Gjinovci, simboli i hendbollit të Kosovës

PRISHTINË, 5 GUSHT - Hendbolli i Kosovës ka mbetur pa personalitetin e shquar të tij. Të hënën ka ndërruar jetë sekretari i përgjithshëm i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Izet Gjinovci. Gjinovci ka ndërruar jetë në moshën 63-vjeçare.

I ndjeri Gjinovci ia ka kushtuar gjithë jetën sportit të hendbollit. Detyrat e tij si sekretar i përgjithshëm i ka kryer me përkushtim dhe pasion shembullor deri në frymën e fundit. Kontributi i tij për zhvillimin e hendbollit të Kosovës është kolosal.

Pas karrierës së suksesshme si hendbollist i Prishtinës, i ndjeri Gjinovci mori drejtimin e klubit prishtinas. Ka sakrifikuar shumë për ta udhëhequr klubin me sukses, ndërsa në një periudhë e kishte shkrië gjithë pasurinë për mbarëvajtjen e klubit. Ka kontribuar në pavarësimin e sportit të Kosovës, ndërsa në



vitet nëntëdhjetë, kur sporti kishte misionin e kundërvënies ndaj pushtuesit, është shquar me angazhimin e pandalshëm. Ishte pjesë e organizimeve të rëndësishme të hendbollit dhe pjesë e pandashme e tij. Prej vitit 2002 e deri në ditën e fundit të jetës e ka kryer me sukses të plotë punën e sekretarit gjeneral

të Federatës së Hendbollit të Kosovës. Ka udhëhequr procesin e lobimit ndërkombëtar, së bashku me presidentin e nderit të FHK-së, Mexhid Devaja. Suksesi ishte madhështor.

Që në vitin 2004, një dekadë para sporteve të tjera ekipore, FHK-ja u pranua me të drejta të

kufizuara në Federatën Evropiane të Hendbollit. Klubet e Kosovës e fituan të drejtën e paraqitjes në gara evropiane dhe kontributi i Izet Gjinovcit në këtë proces ishte i madh. Më pas, së bashku me presidentin e FHK-së, Eugen Saraçini, kanë udhëhequr procesin e pranimit të plotë në EHF e IHF. Edhe ky proces u përbyll me sukses të plotë. FHK-ja u pranua e para prej federatave të sporteve kolektive. Raportet e të ndjerit Gjinovci me komunitetin e hendbollit në vend ishin shembullore. Ai është vlerësuar e është çmuar në secilin mjedis ku është paraqitur. Edhe raportet me drejtues të IHF-së e EHF-së dhe të federatave të tjera nacionale i kishte të shkëlqyera. Është dalluar për karizmin që i ka mundur qasje në nivelet më të larta të hendbollit ndërkombëtar. Prej 23 prillit të vitit 2021, Gjinovci ishte anëtar i

Gjykatës së Apelit të EHF-së. Në këtë organ të rëndësishëm ishte zgjedhur me votat e anëtarëve të Kongresit të EHF-së. Ishte prej më të votuarve dhe kjo dëshmon për respektin që ka gëzuar në nivelet ndërkombëtare të hendbollit. I ndjeri Gjinovci ka kontribuar në zhvillimin e hovshëm të ekipeve tona kombëtare, dy kualifikimet historike në Botëror dhe arritjen në nivele gjithnjë e më të larta me Kombëtares A. Bashkëpunimin me federatat e tjera të vendit dhe me institucionet shtetërore e kishte të shkëlqyer. Dyert i ka pasur të hapura në çdo vend falë punës së madhe që e ka kryer. Me ndarjen nga jeta të Gjinovci, hendbolli i Kosovës dhe FHK-ja kanë mbetur pa një shtyllë shumë të rëndësishme. FHK-ja i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes shumë të nderuar Gjinovci.

## Ballkani dhe Drita mësojnë rivalët e mundshëm nëse kualifikohen në 'play-off' të Ligës së Konferencës

PRISHTINË, 5 GUSHT - Dy skuadrat e Kosovës që ende janë pjesë e garave evropiane në këtë edicion, Ballkani dhe Drita, kanë mësuar kundërshtarët e mundshëm në rast të kualifikimit në "play-off"-in e Ligës së Konferencës.

Kampioni në fuqi, Ballkani, nëse arrin t'i kalojë me sukses dy sfidat me skuadrën nga Irlanda e Veriut, Larne, në "play-off" do të përballë me fituesin e duelit ndërmjet Lincoln RedImps dhe Dinamo Minsk. Ndërkaq Drita, nëse e kalon me sukses pengesën e radhës, Auda nga Letonia, në "play-off" do të ketë punë me fituesin e përballjes ndërmjet Legia Varshava dhe Brondby.



## Mahuchikh ua dedikon medaljen e artë sportistëve të vrarë në Ukrainë

Paris, 5 gusht - Atletja ukrainase e kërcimit së larti, Yaroslava Mahuchikh, ua ka kushtuar medaljen e artë olimpikë atletëve të vrarë në pushtimin rus në vendin e saj. Lufta filloi në shkurt të 2022-s dhe nuk ka asnjë shenjë të fundit. Vetëm 15 sportistë rusë përfunduan në Paris, kështu që Ukraina vendosi të konkurronte dhe mbajtësja e rekordit botëror Mahuchikh ishte e lumtur për këtë. "Kjo medalje është e rëndësishme, por Rusia vrau njerëz në vendin tim", u ka thënë 22-vjeçarja gazetarëve. "Pothuajse 500 sportistë vdiqën në luftë dhe kurrë nuk do të mund të marrin pjesë në gara. Ata kurrë nuk do të festojnë, nuk do ta ndiejnë kurrë këtë atmosferë, kështu që jam veçanërisht e lumtur për këtë medalje. Është për të gjithë ata", theksoi ajo.



## Visar Kastrati do ta ndajë drejtësinë në Ligën e Konferencës

PRISHTINË, 5 GUSHT - Visar Kastrati i besohet nga UEFA edhe një tjetër ndeshje në Ligën e Konferencës, raundi i tretë. Noa - AEK Athens është ndeshja që do të gjykohe

nga gjyqtari i Kosovës, Visar Kastrati. Në ndeshjen që do të zhvillohet në stadiumin e qytetit në Abovyan të Armenisë, gjyqtarin Kastrati do ta asistojnë Edmond

Zeqiri dhe Fatmir Sekiraqa, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Mentor Ajeti. Për herë të parë në këtë ndeshje do të ketë edhe VAR dhe AVAR nga

Kosova, ku do të jenë gjyqtari Alban Shala dhe asistenti Granit Hyseni. Kjo ndeshje do të zhvillohet të martën, më 6 gusht, me fillim në orën 18:00.





### NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Madame Boutique Sh.p.k me numër unik identifikues: 812043818 me seli në Prishtinë, Adresa: Rrustem Statovci, Blloku i ri, ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Granit Baliu me ID: 1231043574 me vendbanim në: Rr. Isa Kastrati nr. 78 Albing Residenc Komuna: Prishtine me tel: 049/834-824

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik

që kanë interesa të porealizuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “PICKLED” SH.P.K. me seli në Fushë-Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811962473 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “PICKLED” D.O.O. Fushë-Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811962473 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “PICKLED” L.L.C. with headquarters Fushë-Kosovë, has come to the decision to quit its business: 811962473 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjeji PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeji Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Veton Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811974303.

- Lëshoj lokalim në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellese. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

